



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**SBM GRUP**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L08218901B**, me seli:
*Dibër, KLOS, KLOS, Bulevardi “Rexhep Pashë Mati”, pallati nr.1, shkalla nr.1,
apartamenti 4, kati 2.*

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Punë**”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: **REF-77872-08-18-2023.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksion i terrenit sportiv Koms, Bashkia Mat**”, me fond limit në vlerën: **1 748 171** (një milion e shtatëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**, nga granditë në vlerën: 1 261 712.67 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, dhe nga fonde të tjera në vlerën: 486 458.33 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre, me afat realizimi: **30** (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 73, datë 28 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “SBM GRUP” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L08218901B**,
Vlera: **1 737 550** (një milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**

2. Operatori Ekonomik: “SUPER BETON MATI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J67902908A**,

Vlera: **1 748 171** (një milion e shtatëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) lekë
pa TVSH

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “SUPER BETON MATI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J67902908A,

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës, shoqëria “SUPER BETON MATI” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;...

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni: Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, dhe Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.2 dhe 2.2.3/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2023 për adresën ku ai ushtron aktivitetin sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, nuk është paraqitur Bilanci i vitit financiar 2022, dhe nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8*, në të cilin deklarohet shlyerja e detyrimeve të taksave vendore.
- III. Nuk është përmbushur kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur dokumentacion për vërtetimin e përvojës së mëparshme (*punë të ngjashme*).
- IV. Nuk është përmbushur kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur licenca profesionale e zbatimit të punimeve.
- V. Nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, dhe 2.3.7 gërma “a/b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8*, në të cilin deklarohet përmbushja e këtyre kriterëve.
- VI. Nuk është përmbushur kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur grafiku i punimeve

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**SBM GRUP**” Sh.p.k., me seli: *Dibër, KLOS, KLOS, Bulevardi “Rexhep Pashë Mati”, pallati nr.1, shkalla nr.1, apartamenti 4, kati 2*, me numër Nipt-i: **L08218901B**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1 737 550** (*një milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë*) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** (*dhjetë*) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor